

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i brendshëm: **205-24-3725-5-1-1** Vendorsja e Sinjalizimit dhe pasijeve rrugore ne Autoudhen R7, Morin Gjurgjicë, segmenti Fushe Kosove- Besi si dhe R6 kryqezimi R6 R7 Rreth Rrotullimi R6 R25.2 - LOT 1

### ANKESË

**“ITK” SH.P.K ; NSH “Liriu”**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rruga Zhuj Selmani pa, n Peje**

(Adresa)

**Peje**

(Vendi)

**30000**

(Kodi postar)

**049 208 100**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**GELOR SHALA**


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**[info@itk-ks.com](mailto:info@itk-ks.com)**

(Adresa elektronike)

**14.05.2025**

(Data e parashtrimt të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

- Kërkesa për Rishqyrtim – 30.04.2025
- Njoftimi mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim – 05.05.2025
- Ankesa në OSHP – 14.05.2025

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e zbatimit të aktiviteti të prokurimit me titull: **Vendosja e Sinjalizimit dhe pasijeve rrugore në Autoudhen R7, Morin Gjurgjicë, segmenti Fushe Kosove- Besi si dhe R6 kryqezimi R6 R7 Rreth Rrotullimi R6 R25.2** me NRP: 205-24-3725-5-1-1 LOT 1 nuk ka respektuar dispozitat Ligjit për Prokurim Publik nr. Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068, Nr. 05/L-092, dhe Udhëzuesin Operative dhe Rregulloret e Prokurimit si ne vijim:

Nenin 1 të LPP-se

Nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 10 – i LPP-se

Neni 11 i LPP-se

Neni 40 të RRRPP

Neni 59 të LPP-së

Neni 8 i UOPP

*\*\* Sipas Neni 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

**Sipas Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje ligjore :**

AK me rastin e publikimit të vendimit mbi dhënien e kontratës kunderligjshëm na ka anashkaluar neve si OE të përgjegjshëm prandaj ju parasqesim pretendimet tona dhe deshmite mbi pretendimet si me poshte:

### Pretendimi 1:

Pretendimi ynë ka të bëjë me vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe arsyetimin e përdorur



për eliminimin tonë nga aktiviteti i prokurimit, të cilin e kanë arsyetuar si më poshtë:

Oe nuk është i përgjegjshëm dhe nuk i plotëson kërkesat e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 2. Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës në vlerë Lot 1 180,000.00Euro, Lot 2 180,000.00Euro dhe Lot 3 150,000.00Euro, duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin në fjalë ose qasje në kredi të pa kushtezuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia.

2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi të pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vëltur nga institucioni Bankar.

Oe ka dështuar të plotësojë kërkesën e FDT dhe DT sepse i njëjti ka paraqitur leter nga banka duke mos specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin në fjalë andaj në këtë pikë është i pa përgjegjshëm

Sipas dosjes së tenderit dhe FDT-së është kërkuar:

### Kërkesa:

2. Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës në vlerë Lot 1 180,000.00Euro, Lot 2 180,000.00Euro dhe Lot 3 150,000.00 Euro, duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin në fjalë ose qasje në kredi të pa kushtezuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia.

### Dëshmia:

2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi të pakushtezuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vëltur nga institucioni Bankar.

Në kemi dorëzuar bashkë me ofertën deklaratën (konfirmimin) e bankës mbi gjendjen e llogarisë, në të cilën konfirmohet se në llogari ka mjete të mjaftueshme, sipas dëshmive të kërkuara në dosjen e tenderit. Përmes kësaj dëshmohet se ne, si subjekt juridik, i kemi mjetet në llogari dhe se ato janë rezultat i aktiviteteve tona të biznesit.

Account number: 30044666 Date of registration: 18.06.2008  
Registry name: ITK SHPC Residential (Y/N): Resident  
Business reg no: 7000125 Residence country: Kosovo  
Document type: Certificate of Registration Activity type: Activated e fers p.z.t.

Address type: Country: Kosovo Zip code: 30000 Street address: Zvezdani 1/1  
Office Address: Kosovo Page: Page: 30000 Zvezdani 1/1

Contact type: Contact details: Contact status:  
Address e-mail: info@itk-shpc.com Active  
Business Registration Model: +383-43884888 Active  
Resident Registration Model: +383-43884888 Active

Account number	Status	Balance	Line Account type	Relation	Curr
3000113026723020146	Active	182,314.00	0.00 Lines open	Master / submaster	EUR
3000113026723020147	Active	0.00	0.00 Lines open	Master / submaster	EUR
3000113026723020148	Active	0.00	0.00 Lines open	Master / submaster	EUR

To whom it may concern  
We hereby confirm that the above mentioned person with all actual detailed information is PCR client.

Date: 18.02.2023  
ProCredit Bank

I njëjti dokument është lëshuar nga banka dhe është vëltur e nënshkruar, me qëllim të dëshmimit të vërtetësisë së tij.

Duke vërejtur njëanshmërinë e Autoritetit Kontraktues në vlerësimin e këtij kriteri, kemi kontaktuar bankën dhe kemi kërkuar sqarim lidhur me çështjen e shfrytëzimit të mjeteve që ndodhen në llogarinë e klientit. Si përgjigje, kemi pranuar një sqarim zyrtar, me të cilin konfirmohet se banka nuk ndërhyr në afarizmin e klientëve të saj – në këtë rast të ITK-së si klient – dhe nuk përcakton se si Operatorët Ekonomikë i shfrytëzojnë këto mjete.

From: ITK International Traffic Kosova <[info@itk-ks.com](mailto:info@itk-ks.com)>  
Sent: Monday, April 28, 2025 2:45 PM  
To: Flokart Ademi, PCB KOS <[Flokart.Ademi@procredit-group.com](mailto:Flokart.Ademi@procredit-group.com)>  
Subject: Kërkesë për lëshimin e një letre konfirmimi

I nderuar,

Në cilësinë e klientit tuaj përmes subjektit juridik ITK SHPK me logari bankare nr. XK0511302671230000166 të hapur në institucionin tuaj, ju drejtohem me këtë kërkesë për lëshimin e një letre konfirmimi.

Duke pasur parasysh se aktualisht jemi pjesëmarrës në një procedurë tenderimit të organizuar nga **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS** dhe në kuadër të sqarimit të një Çështje të ngritur nga Autoriteti Kontraktues, na nevojitet konfirmimi zyrtar nga ana juaj se:

- Mjetet monetare të depozituara në logarinë tonë të sipërpërmendur përfaqësojnë të hyra nga aktiviteti i regullt afarist të kompanisë sonë;
- Banka nuk përcakton destinimin e përdorimit të këtyre fondëve dhe nuk vendos kufizime lidhur me qëllimin për të cilin ato shfrytëzohen;
- Nëse si kompani jemi të lirë të menagjojmë dhe disponojmë fondet tona në përputhje me interesat tona afariste, pa asnjë pengesë apo kufizim nga ana e institucionit tuaj.

Duke marrë parasysh rëndësinë dhe urgjencën e Çështjes, ju lutem që këtë konfirmim ta bëni të disponueshëm në një afat sa më të shkurtër.

Në pritje të bashkëpunimit tuaj, ju falënderojmë paraprakisht për mirëkuptimin dhe mbështetjen.

Me respekt

Me respekt / Best Regards

ITK SHPK  
Tel: 049 105 105, 049 208 100, 049 733 073  
Web: [www.itk-ks.com](http://www.itk-ks.com)  
Address: Rruga St. Zhujë Selman  
Prishtinë / Business Center

Dhe me poshte pergjigja:

From: **Flokart Ademi, PCB KOS** <[Flokart.Ademi@procredit-group.com](mailto:Flokart.Ademi@procredit-group.com)>  
Date: Tue, Apr 29, 2025 at 1:50 PM  
Subject: RE: Kërkesë për lëshimin e një letre konfirmimi  
To: ITK International Traffic Kosova <[info@itk-ks.com](mailto:info@itk-ks.com)>

Pershendetje,

Në bazë të kërkesës suaj dhe me dokumentacionet e nevojshme të bankës, mjetet monetare në llogarinë e ITK SHPK janë mjete që përfaqësojnë të hyra nga aktiviteti i rregullt afarist.

Banka nuk përcakton destinimin e përdorimit të mjeteve perderisa nuk janë në kërkesë të ndonjë produkti bankar që nevojitet destinimi në bazë të faturave, kështu që banka nuk vendos kufizime lidhur me qëllimin për të cilin ato shfrytëzohen.

Patjetër që biznesi ITK SHPK janë të lirë që të menagjojnë fondet e tyre në përputhje me intereset e saj afariste dhe që banka perderisa janë mjete të fituara nga të hyrat e biznesit pa ndonjë produkt bankar atëherë banka nuk ka ndonjë kufizim në raport me këtë.

Me respekt!

Flokart.



**Flokart Ademi**  
Business Client Adviser

A: Xhorxh Bush nr. 26, 10000, Prishtinë  
T: +383 38 555 777 ext: +383 49555542  
M: +383 49555542

[www.procreditbank-ks.com](http://www.procreditbank-ks.com)

Siç shihet nga përgjigja, banka e konfirmon se nuk ndërhyr apo nuk përcakton destinimin e përdorimit të mjeteve, perderisa nuk janë në kërkesë të ndonjë produkti bankar, dhe këto mjete në si OE i kemi të lira t'i shfrytëzojmë, perderisa i kemi zotuar me anë të dokumentit se janë për aktivitete afariste, të cilat do të shfrytëzohen në këtë kontratë.

Prandaj si rezultat në kosndierojme se AK ka shkelur parimet baze të LPP-së:



Sipas nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Autoritetet Kontraktuese janë të obliguara të respektojnë parimet bazë të barazisë, mosdiskriminimit dhe transparencës, gjatë gjithë procesit të prokurimit. Gjithashtu, AK ka për obligim të vlerësojë ofertat në përputhje me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të mos ndërmarrë interpretim subjektiv të dokumenteve të ofertuesve.

Në rastin konkret, AK ka bere shkelje te parimeve baze te LPP\_se.:

- Ka bërë një interpretim të ngushtë dhe të njëanshëm të kërkesës për kapital financiar, duke mos pranuar një dokument të vlefshëm dhe autentik të lëshuar nga një institucion financiar i licencuar, që dëshmon se Operatori Ekonomik posedon mjete të gatshme sipas kërkesës së tenderit.
- Nuk ka respektuar faktin që llogaritë bankare të operatorit janë mjete të disponueshme dhe të pakushtëzuara, përderisa banka nuk ka vendosur asnjë kufizim në shfrytëzimin e atyre mjeteve – për çka është dhënë edhe një sqarim shtesë nga banka.
- Në këtë mënyrë, AK ka ndërmarrë vendim të padrejtë dhe diskriminues, duke eliminuar OE-në pa arsye objektive dhe pa vlerësim të drejtë të dokumentacionit

Në dosjen e tenderit thuhet qartë se kërkohet:

- **Dëshmi për mjete të gatshme**, përmes një dokumenti origjinal, të nënshkruar dhe të vulosur nga banka.

Ne si OE kemi dorëzuar:

- **Dokument të nënshkruar dhe vulosur nga banka**, që dëshmon qartë ekzistencën e mjeteve të gatshme në llogarinë bankare të OE-së, me vlerë të mjaftueshme sipas kërkesave të Lot-eve.

Prandaj, **arsyetimi i AK-së për eliminim bie ndesh me vetë përmbajtjen e kërkesës së dosjes së tenderit** dhe për rrjedhojë është:

- **I paarsyeshëm** – sepse nuk mbështetet në fakte të mjaftueshme ose prova që vërtetojnë mungesën e kapacitetit financiar. Per me teper sipas UOPP 001/2023 nuk kerkohet ne asnje rast qe kerkesa per asete likuide te behet me emer te projektit sepse asetet likuide sikurse jane dhene edhe ne pergjigjen e bankes jane prone e OE dhe banka nuk paraqet kufizime per shfrytezim.

**Shembull:**

**Kërkesa 1.** Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 500.000 euro asete likuide financiare (për shembull në llogarinë bankare) ose të paktën 500.000 euro qasje për kredi në dispozicion.

**Dëshmia dokumentare 1.** Deklarata nga banka që vërteton disponueshmërinë e 500.000 euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej 500.000 EUR, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.

- **I paligjshëm** – sepse bie në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, ku thuhet se AK duhet të eliminojë vetëm ato OE që nuk përmbushin kërkesat **siç janë të specifikuara në dosjen e tenderit**, e jo për shkak të interpretimit subjektiv të dokumenteve të vlefshme.

Si rezultat ne vleresojme se AK gjate vleresimit te ofertes sone e ka shkelur nenin 7 dhe 59 te LPP-se si dhe nenin 40 te RRPP si dhe nenin 8.5 te UOPP dhe se gjate rekomandimit per kontrate nuk e ka respektuar nenin 1 te LPP-se.

## Pretendimi 2:

**Pretendimi ynë lidhet me mosrespektimin e të drejtës për qasje në dokumente zyrtare, në përputhje me nenin 10.3 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).**

Ne, si Operator Ekonomik palë e interesuar në këtë aktivitet të prokurimit, kemi paraqitur kërkesë për qasje në të gjithë dokumentacionin përkatës, me qëllim të mbështetjes së pretendimeve tona në mënyrë të plotë dhe të argumentuar.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 11.4 të LPP-së, i cili obligon që palës së interesuar t'i ofrohet qasje në versionin e pastruar të dokumenteve të ofertuesve tjerë. Në vend të kësaj, neve na është dhënë qasje vetëm në dokumente të parëndësishme dhe që nuk kanë të bëjnë me LOT-in 1, për të cilin jemi eliminuar dhe për të cilin kemi ushtruar ankesë.

Edhe perkunder faktit që na është mundësuar Qasja në Dokumente ajo qasje ka qenë shumë e kufizuar dhe dokumentet e pranuar kanë qenë vetëm keto **“Sigurimi i Tenderit, Certifikata e biznesit dhe informatat percjellese, Pasqyrat Vjetore nga ATK, Marreveshja mbi themelimin e Konzorciumit, Deklarata në Betim, FDT, Lista e Kontratave (pa dokumentet percjellese) dhe Lista e Paisjeve për LOT 3 (pa dokumentet percjellese) kurse për lot 1 ku ne kemi marrë pjesë asnjë dokument nuk na është dhënë.**

Vetëm keto dokumenta janë që na janë dorëzuar, dhe fizikisht në zyrë na është thënë që mundemi të shiqoni dokumentet këtu nga PC por marrë parasysh volumin e madhe të dosjes së tenderit në vlerësojme se një qasje e tillë për një afat kaq të shkurt (thënë ndryshe brenda 5 minuta) është e pamundur të kontrollohet dosja dhe dokumentet të cilat në rrethana normale duhet të na ishin dorëzuar në CD dhe pastaj ne të kemi mundësi të shiqojmë një nga një dhe të bëhet analiza e tyre konform procedurës.



Për më tepër, sipas informatave tona, një Operator Ekonomik tjetër, i cili gjithashtu ka ushtruar ankesë për të njëjtin aktivitet të prokurimit, ka pasur qasje të plotë në dokumentacion, ndërkohë që neve nuk na është ofruar trajtim i njëjtë dhe i barabartë.

Kjo përbën shkelje të nenit 11 të LPP-së, si dhe shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë të përcaktuar në nenin 7 të LPP-së, duke na vendosur në pozitë të pabarabartë dhe diskriminuese, pavarësisht se kemi interes të drejtpërdrejtë material në këtë aktivitet të prokurimit.

## Pretendimi 3:

Pretendimi ynë ka të bëjë me Ankesën 1 – Listën e mjeteve dhe stabilimenteve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit.

**4. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit tek Aneksi 1.**

Deshmia 4. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet të dëshmojë me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. **Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga**



te dyja palët. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Deshmit per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listes se bashkangjitur ne Aneksin 1. Gjithashtu deshmit duhet te jene te dukshme.

Te pika 3 e dosjes së tenderit, përkundër faktit se nuk na është dhënë qasje e plotë në dokumentet, sipas kërkesës së nenit 10 të LPP-së, dhe bazuar në dokumentet që GOE i rekomanduar për kontratë i posedon në të gjitha aktivitetet tjera të prokurimit, ne kemi dyshime se në këtë pikë, ku kërkohet:

**Makinë special për ngjyrë me masë plastike:**

I. Makina duhet të ketë mekanizëm për vendosjen e materialet nga plastika në gjerësi  $\geq 15\text{cm}$ ;

II. Makina duhet të ketë te integruar edhe shpërndarjen e fosforit;

III. Makina duhet te ketë mekanizëm për vendosjen e materialet nga plastika me trashësi, sipas specifikave teknike.

IV. Kapaciteti mbajtës i rezervuarit min 300 kg;

GOE i rekomanduar për kontratë dyshojmë se ka prezantuar në ofertë një kontratë për marrje me qira të pajisjes, që sipas kushteve të kontratës është lidhur për vetëm 24 muaj, e që është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit: “Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes së kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.”

Kjo përbën një shkelje të nenit 7 dhe 59 të LPP-së, në radhë të parë duke na diskriminuar neve dhe duke na eliminuar në mënyrë subjektive, ndërsa për GOE-në e rekomanduar i mbyll sytë dhe e merr të mirëqenë. Po ashtu, AK gjatë vlerësimit ka shkelur nenin 40 të RRPP-së si dhe nenin 59 të LPP-së, kështu duke na eliminuar ne si OE i përgjegjshëm.

Pretendim tjetër në këtë pikë është noterizimi i marrëveshjes së GOE për pajisjet e marra me qira. Ne dyshojmë se noterizimi i marrëveshjes nuk është bërë në përputhje me kërkesat e tenderit. Sipas qasjes që ju ka dhënë disa operatorëve në mënyrë selektive, dhe ndërkohë që neve nuk na është ofruar trajtim i njëjtë, kemi informata se noteri ka potencuar në dokumentin e noterizimit se “nuk ka mundur të informohet për përmbajtjen e dokumentit që e noterizon për shkak të gjuhës së dokumentit”. Po ashtu thekson se “noterizimi nuk i referohet korrektësisë së dokumentit”.

Prandaj, ne vlerësojmë se AK, prapë gjatë vlerësimit në këtë pikë, ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm, në kundërshtim me nenin 40 të RRPP-së dhe nenin 59 të LPP-së, dhe se neve si OE na ka eliminuar për një dokument për të cilin edhe banka ka deklaruar se është përgjegjësi e OE-së se si menaxhon me të hyrat nga biznesi afarist dhe se nuk ndërhyr në asnjë mënyrë se si shpenzohen ato.

**Bazuar në të gjitha pretendimet e shënuara më lart në këtë ankesë, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ankesa jonë të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të urdhërohet AK – Ministria e Infrastrukturës të kthejë lëndën në rivlerësim dhe të shpallë ofertën tonë si fituese të këtij projekti, pasi që është edhe oferta më e lirë.**



## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Demet e shkaktuara janë shpenzimet ne përgatitjen e ofertës, dëme ne reputacion dhe fitimi i humbur.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.